



BULETIN INFORMATIV

KORRIK - SHTATOR 2024

Publikohet Raporti i Performancës për Shoqëritë UK 2023

Në përmbushje të detyrimit ligjor ERRU, si një institucion publik i pavarur, përgjegjës në nivel kombëtar për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, ka hartuar dhe bërë publik në muajin korrik 2024 Raportin e Performancës së Shoqërive Ujësjellës Kanalizime. Raporti përshkruan dhe analizon performancën dhe zhvillimet në sektorin e ujësjellës kanalizimeve dhe të çdo shoqërie UK brenda periudhës kalendarike 1 janar - 31 dhjetor 2023. Ky vit konsiderohet si viti i parë i implementimit të reformës në sektorin e ujit në Shqipëri, ku deri në mbyllje të vitit janë krijuar 14 shoqëri UK Rajonale nga 15 të parashikuara sipas reformës, ndërkohë që në sektor akoma operojnë 3 shoqëri UK ekzistuese si UK Tiranë, Kamëz dhe Vorë, të cilat pritet që të jenë pjesë e shoqërisë së re Rajonale UK Tiranë. Reforma në sektorin UK gjatë vitit 2023, ka dhënë impaktin e vet në drejtim të përmirësimit pothuajse në të gjithë treguesit e saj dhe në veçanti të situatës financiare të sektorit krahasuar me vitin paraardhës 2022 i cili ka qenë një ndër objektivat kryesorë të reformës. Raporti i Performancës është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektor. Ai jep një pasqyrë të sektorit krahasuar me vitin paraardhës dhe tendencën e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri bazuar në një analizë dhe vlerësim sa më objektiv të performancës së sektorit e cila shoqërohet me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të shoqërive UK. Raporti në të njëjtën kohë shërben edhe si një mjet për shoqëritë UK për të krahasuar performancën e tyre me ato të shoqërive të tjera. [Raporti i plotë:](#)

PËRMBAJTJA

- **RAPORTI I PERFORMANCËS**
- **VENDIMET E KKRR**
- **PJESËMARRJA NË AKTIVITETE**

EVENTET NË FUSHËN E UJIT

- **16 - 17 Tetor**
Konferenca e 5-të Ndërkombëtare e Aquasan, Bosnje-Hercegovinë
- **5 - 7 Nëntor**
Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike e SHUKALB, Prishtinë, Kosovë
- **20 - 21 Nëntor**
Mbledhja e Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë të OECD, Paris, Francë
- **Dhjetor**
Asambleja e Përgjithshme e 36-të e WAREG

VENDIMARRJA E KKRR

Përgjatë muajve korrik, gusht dhe shtator Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar disa mbledhje duke marrë disa vendime me rëndësi në sektorin e operimit të shoqërive ujësjellës kanalizimeve. Midis tyre veçojmë:

- ✓ Vendim për miratimin e Raportit të Performancës për shoqëritë Rajonale UK për vitin 2023
- ✓ Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Gjirokastër”
- ✓ Vendim “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.a”
- ✓ Vendim “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër Sh.a”
- ✓ Vendim “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të nivelit të ri tarifor për Shoqërinë Rajonale UK Korçë Sh.a”
- ✓ Vendim mbi disa ndryshime në rregulloren “Për rekrutimin, vlerësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në Entin Rregullator të Ujit”
- ✓ Vendim mbi aplikimin për rinovim licence të shoqërisë rajonale UK Durrës Sh.a për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë
- ✓ Vendim për miratimin e Strategjisë Institucionale të ERRU-së për periudhën 2025 – 2027
- ✓ Vendim për caktimin e Znj. Evis Shurdha, Zëvendëskryetare të KKRR me një mandat 1 vjeçar

LICENCA

Në tre mujorin e tretë të vitit 2024 pranë ERRU është paraqitur një kërkesë si dhe ka marrë miratimin nga KKRR kërkesa për rinovim licence nga Shoqëria Rajonale UK Durrës. Në sektorin e ujit operojnë aktualisht 19 shoqëri ujësjellës kanalizime, 13 prej të cilave të licencuara si shoqëri rajonale: Shoqëria Rajonale UK Durrës, Lezhë, Korçë, Kukës, Gjirokastër, Berat, Fier, Lushnje, Pogradec, Elbasan, Sarandë, Dibër, Shkodër; si dhe 6 shoqëri të tjera UK: Tiranë, Vorë, Kamëz, Vlorë, Selenicë dhe Himarë.

TARIFA

Përgjatë muajve korrik-shtator, Komisioni Kombëtar Rregullator ka marrë një vendim për miratimin e nivelit të ri tarifor për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec, duke e çuar në pesë numrin e shoqërive rajonale që operojnë me tarifa të reja, që pas reformimit të sektorit të ujit. Në këtë hark kohor, gjithashtu KKRR ka marrë vendim dhe ka nisur procesin e analizës për propozimet e shoqërive për nivel të ri tarifor. Më konkretisht për: Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër, UK Korçë, UK Shkodër.



Integrimi në BE, ERRU në takim e Kuvendit të Shqipërisë me drejtuesit e institucioneve të pavarura



Në 26 shtator, Kryetarja e Kuvendit, Znj. Elisa Spiropali ka zhvilluar një takim me drejtuesit e institucioneve të pavarura, kushtetuese dhe të krijuara me ligj, në të cilin Enti Rregullator i Ujit u përfaqësua nga Zv.kryetarja e Komisionit Kombëtar Rregullator, Znj. Evis Shurdha.

Në tryezën e diskutimeve, kryetarja e Kuvendit vuri në dukje rolin e institucioneve të pavarura si roje të interesit publik e qytetar, duke e cilësuar bashkëpunimin dhe kontributin e tyre thelbësor në realizimin e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit. Po ashtu, legjitimiteti e gjithëpërfshirja e procesit të integritit evropian janë të lidhura pikërisht me bashkëpunimin e Kuvendit me institucionet e pavarura. Për këtë arsye, Znj.Spiropali premtoi rritje të mbështetjes politike, ligjore dhe financiare për ta. Në takim morën pjesë Ambasadori i BE, Z. Silvio Gonzato, Zëvendësdrejtuesja e Komanduar e Misionit të SHBA, Znj. Kathryn Hammond, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Z. Nick Abbott, Ambasadori i Vendeve të Ulëta, Z. Reinout Voss si dhe kryetarët e komisioneve të përhershme të Kuvendit.

Menaxhimi i aseteve, ERRU trajnime me stafet e shoqërive UK

Përfaqësues nga Drejtoria Tekniko Ekonomike në Entin Rregullator të Ujit po zhvillojnë një cikël trajnimesh me stafet e shoqërive rajonale UK, me mbështetjen e Partneritetit të Danubit dhe Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve të Shqipërisë. Drejtori i Drejtorisë Tekniko-Ekonomike, Z.Sokol Kraja së bashkë me Znj.Etleva Demiri, përgjegjëse e Sektorit Teknik dhe Licencave dhe Znj.Nevila Saliu, përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe Tarifave zhvilluan trajnime mbi Menaxhimin e Aseteve, Inventarin e Aseteve dhe Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave duke trajnuar dhe angazhuar stafet ujësjellëse në ushtrime praktike për të zbuluar njohuritë e tyre. Qëllimi i këtij cikli trajnimesh është që deri në fund të tyre, pjesëmarrësit të pajisen me njohuritë e duhura për të zbatuar parimet e menaxhimit të aseteve, duke përfshirë plotësimin e inventarit, vlerësimin e kushteve të aseteve dhe përcaktimin e aseteve kritike bashkë me kostot e tyre. Ata gjithashtu mësojnë të vendosin nivele shërbimi, të zbatojnë procedurat e mirëmbajtjes, të menaxhojnë ciklet e jetës së asetevedhe të identifikojnë burimet e financimit për



programet e menaxhimit të aseteve. Trajnimet e moderuara nga përfaqësuesit e ERRU u zhvilluan në mënyrë interaktive. Ujësjellësit nuk ishin vetëm dëgjues pasivë, por u angazhuan në plotësimin e tabelave për regjistrimin e aseteve bazuar në modelet e dhëna nga trajnerët dhe me ndihmën e tyre, si dhe planeve të veprimit rast pas rasti. Dijet e praktika e fituar në këto cikle trajnimi është një ndihmesë e madhe për pjesëmarrësit, të cilët do t'i praktikojnë në shoqëritë respektive ku ata punojnë.

